

KRIKË E BIBLIOGRAFI

Gr. Brîncuş, *Über die einheimischen lexikalischen Elemente im Rumänischen* (Mbi elementet leksikore autoktone në rumanishten) «Revue des études sud-est européennes, Tome I 1963 Nr. 3-4 309-317 pp.».

Ky artikull i gjuhëtarit rumun Gr. Brîncuş përbën një përpjekje të re për të ndriçuar një problem kaq të ndërlikuar, siç është problemi i shpjegimit të lidhjeve gjuhësore shqiptaro-rumun në përgjithësi dhe i elementëve të përbashkëta leksikore në veçanti. Siç e sqaron vetë me anë të një shënimi, autori fjalën autokton e përdor me kuptimin trako-dak dhe si elemente leksikore autoktone, d.m.th. trako-dake njuh të gjitha ato fjalë që në rumanishten nuk mund të shpjegohen as si latine, as si sllave, as si hungareze etj. Për interpretimet e ndryshme që u bëhen shumicës së këtyre elementeve autori me të drejtë numëron si arësye objektive faktin se trakishtja, d.m.th. substrati i rumanishtes, nuk njihet, dhe se burimi i shqipes nuk është caktuar në mënyrë të sigurt. Autori është i detyruar të pranojë se përpjekja për t'i shpjeguar këto elemente me anë të relikteve të pakta e të pa-sigurta të trakishtes, ka mbetur për pjesën më të madhe e pafrutshme, megjithatë, — vijon ai pa asnjë mëdyshje, — kjo nuk e hedh poshtë faktin se fjalët përkatëse janë të burimit autokton (kupto trako-dak). Duke shprehur pikëpamjen e tij se këto fjalë në rumanishten burojnë drejtpërdrejt nga substrati (d.m.th. duke e përjashtuar mundësinë e një marrjeje të drejtpërdrejtë nga shqipja, autori e quan të nevojshme të tërheqë vërejtjen mbi një çështje terminologjike, mbi kuptimin e fjalës substrat në rastin e shqipes dhe të rumanishtes. Duke e bërë një idiomë trake) që ka vazhduar zhvillimin deri sot, po ashtu siç është rumanishtja një latinishte e zhvilluar në krahinat danubiane. Pra, sipas tij, ajo që në rastin e rumanishtes është substrati, në rastin e shqipes përbën vetë shtratin e mirëfillt të gjuhës.

Duke pohuar që fjalët e cilësuar si autoktone në rumanishten vijnë drejtpërdrejt nga substrati, autorit i duhet të shpjegojë se si ka qenë e mundur që këto fjalë të jenë ruajtur pa u zëvendësuar me fjalë latine. Ai tërheq vërejtjen në faktin që shumica e tyre i përkasin terminologjisë baritore. Sipas mendimit të tij, pjesa më e madhe e këtyre elementeve u ruajtën në sajë të barinjve që u romanizuan dalëngadalë. Këtë mendim ai e mbështet edhe te vepra *Limba traco-dacilor* (Gjuha e trako-dakëve) e I.I. Rusut, i cili thotë se, pas gjase, trakishtja flitej ende në shek. VI në krahinat malore. Autori e mohon kategorikisht mundësinë e një ndikimi të shqipes mbi rumanishten, pas kohës së formimit të kësaj të fundit, ndikim që të shpjegohej nga një bashkëjetesë e gjatë e të dy popujve, për të cilën bën fjalë E. Çabej në vendin e cituar. Arësytet që shtron Gr. Brîncuş për të mbështetur mendimin e tij janë së pari, pikëpyetja që vë fakti se ky ndikim ka ardhur vetëm nga shqipja dhe nuk është ndërjerë gati aspak në krahun e përkundërt dhe së dyti, trajtimi i ndryshëm në rumanishten i të njëjtëve tinguj të shqipes. Megjithatë autori nuk e përjashton fare mundësinë e një ndikimi reciprok të këtyre gjuhëve. Duke u nisur nga hipoteza e Bariçit se shqiptarët e kishin lënë atdheun e tyre të parë para fundit të epokës latine, por jo më vonë se shek. VI², Gr. Brîncuşi mendon se marrëdhënje të veçuara midis barinjve shqiptarë dhe rumunë mund të kenë vazhduar gjatë shtegtimit të bagëtive, i cili është zhvilluar dalëngadalë, kurrsesi në më-

1) E. Çabej, *Unele probleme ale istoriei limbii albaneze*, «Studii și cercetări lingvistice» X (1959) 4, f. 551, shih dhe përkthimin shqip në «Buletin i USHT SSHSH XVII» (1963) 3.

2) H. Bariç, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1955, f. 70.

nyrë masive dhe ka zgjatur deri vonë në mesjetë. Por këto marrëdhënje sipas Gr. Brënkushit, vetëm kanë ndihmuar për ruajtjen e mbeturinave autoktone në gjuhën e rumunëve. Në përmbyllje të këtyre konsideratave të përgjithshme rreth elementeve autoktone të leksikut rumun autori shprehet se sido që të shpjegohet burimi i këtyre elementeve në rumanishten, është e sigurt se në këtë gjuhë ata kanë ekzistuar që shumë kohë përpara ndikimit sllav dhe janë zhvilluar në bazë të atyre ligjeve që kanë ndihmuar në shndërrimin e latinishtes danubiane në një sistem cilësorisht të ri, të rumanishtes së përbashkët, por nuk thotë se ku bazohet kjo siguri. Pra për të, elementet leksikore të përbashkëta shqiptaro-rumune në rastin e shqipes kanë vazhduar të jetojnë pa ndërprerje në po atë idiomë trake të zhvilluar në truall ilir, ndërsa në rastin e rumanishtes hynë në një leksik «të ri latin», në gjuhën e një popullsie plotësisht të romanizuar.

Siç shihet deri këtu, autori ka zënë që në fillim një pozitë të caktuar në disa çështje themelore, pozitë që ai nuk e argumenton, nuk e mbron duke vënë në peshore argumentat e tij dhe të atyre që kanë një tjetër mendim, por vetëm e deklaron dhe e mban pastaj sikur të ishte një e vërtetë e pakundërshtueshme. Lexuesi mund të vërejë me keqardhje se autori nuk ka përmendur fare qëndrimin e gjuhësisë shqiptare dhe jo vetëm shqiptare, kur ky nuk pajtohet me qëndrimin e tij. Kështu që nga kjo pikëpamje artikulli nuk jep një pasqyrë objektive të gjendjes së studimeve rreth kësaj teme.

Në pjesën e dytë të artikullit të tij autori merret me krahasimin e elementeve autoktone të leksikut rumun me fjalët përgjegjëse shqipe, duke e konsideruar këtë me të drejtë si të vetmen metodë të sigurtë për të sqaruar qoftë edhe pjesërisht leksikon autokton të rumanishtes, pavarësisht nga mendimi i tij për shqipen si vazhduese të trakishtes. Me anë të këtij krahasimi ai synon që këtyre fjalëve t'u zbulohen format origjinare, d.m.th. format që qëndrojnë më pranë etimoneve trake. Me të drejtë autori vë në dukje se nga gjuha shqipe nuk duhen marrë (për t'u krahasuar me fjalët rumanishtes) format e sotme të fjalëve përgjegjëse, po duhen kërkuar format e vjetra që qëndrojnë, sipas pikëpamjes së tij, më pranë shkallës trake të kësaj gjuhe. Ai sjell si shembëlla krahasimi disa fjalë, p.sh. *brad* të rumanishtes e lidh me njëjës in e vjetër **bradh* të shqipes, i cili në rumanishten, sipas tij ka dhënë *braz*. Kjo trajtë, për shkak të tingullit të saj fundor, u ndje si shumë dhe për këtë arsye doli trajta e re e njëjësit *brad*. Më tej ai flet për rum. *grapă* që duhet krahasuar me trajtën e rindërtuar *grap* të shqipes e jo me *grep*, që është një shumësi i singularizuar, po ashtu *țeapă* e rumanishtes duhet krahasuar me **thap* e jo me *thep* (shih për këto E. Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967). Për foljen *bucura* dhe emrin *bucurie* të rumanishtes ai thotë se si bazë e tyre duhet parë një mbiemër *bucur*, i cili mund të krahasohet me shqipen *bukur*. Ky mbiemër në rumanishten është ruajtur deri sot te emri *Bucura*, një mal në masivin Retezat, dhe si emër vetjak.

Më tej Gr. Brënkushi përmend se të njëjtët tinguj të shqipes (te fjalët e përbashkëta) në rumanishten janë pasqyruar në mënyra të ndryshme, p.sh.

th: s thumbull — simbur
c thark — țarc
ç thumb — ciump
f thërrime — fărîmă

dh: z vjedhullë — viezure
d gardh — gard

Duke iu referuar Al. Rosettit (*Istoria limbii romine* II.2.1943, 106), ai thotë se korresponduesit e shumtë dhe të ndryshëm në rumanishten të të njëjtët tingull shqip, janë origjinarisht tinguj të ndryshëm, që në gjuhën shqipe janë shkriër në një tingull dhe që këtej ai nxjerr përfundimin se fjalët që përmbajnë këta tinguj, kanë ardhur në rumanishten, më saktë në latinishten danubiane, nga shqipja e epokës antike, pra nga trakishtja e mirëfilltë. Me këtë rast ai ka vënë në dukje edhe se disa nga ndërrimet fonetike të fjalëve autoktone të rumanishtes vërtetohen edhe të elementit përgjegjës shqipe nëpër dialekte dhe këtë e merr si një provë të qenjes së tendencave të theksuara analogjike nën veprimin e substratit, sado që më parë ka thënë se në rastin e shqipes nuk mund të bëhet fjalë për kurfarrë substrati. Është me të vërtetë e vështirë të merret me mend që disa zhvillime fonetike të kryera në latinishten danubiane, siç thotë Gr. Brënkushi, nga fillimi i epokës së re, të kenë lidhje me zhvillime të ngjashme, relativisht të vona, nëpër dialektet e shqipes, si bie fjala: *qafë-qafë* khs. rum. *ceafă*, *thërrime-fërrime* khs. rum. *fărîmă*, *thumbull-sumbull* khs. rum. *simbure*, *këlbazë-gëlbazë* rum. *câlbează*, *gâlbează* (kjo e fundit është trajta letrare) etj.

Ne mendojmë, përkundrazi, se reflektimi i ndryshëm i të njëjtëve tinguj të shqipes në rumanishten lidhet, natyrisht, me kohën e ndryshme të huazimit të fjalës

shqipe në rumanishten, me dialektin shqip që e ka dhënë atë fjalë dhe me zhvillimet e brëndshme të rumanishtes.

Megjithë arësytimet e mësipërme, autori pohon se një numër fjalësh autoktone të rumanishtes si *barzâ, fârimâ, gâlbeazâ, gresie, hameş, moaşâ, sarbâd, strungâ, viezure* etj., mund të shpjegohen me fjalët përgjegjësi shqipe³. Në rumanishten, format prej të cilave rrjedhin këto fjalë të prejardhura, — vijon ai —, ose kanë humbur ose nuk kanë ekzistuar kurrë. Duke njohur se në shqipen këto fjalë ekzistojnë pranë formave prej të cilave janë formuar ose me të cilat mund të lidhen etimologjikisht, Gr. Brënkushi është i shtrenguar të pohojë gjithashtu se vendi i veçantë që zënë në rumanishten këto fjalë të prejardhura dhe qenja e tyre krahas fjalëve rrënjë të shqipes mund të silleshin si provë që rumanishtja i ka marrë hua këto fjalë prej shqipes relativisht vonë. Ky është një përfundim plotësisht bindës dhe logjik. Duke trajtuar të njëjtin problem, E. Çabej, në vendin e cituar thotë me të drejtë se shumë nga fjalët e përbashkëta të rumanishtes e të shqipes gjejnë një të tillë shpjegim brenda kësaj gjuhe të fundit, që u vë atyre vulën e karakterit shqiptar dhe se brënda shqipes, këto fjalë shpesh herë nuk janë të izoluar, po paraqiten si misat e një familjeje leksikore. Le të përmëndim këtu edhe një arësytim të mprehtë të Rasmus Raskut që e sjell O. S. Shirokovi për një rast të ngjashëm nga fusha e marrëdhënjeve midis shqipes dhe gjuhëve sllave: «Në qoftë se e njëjta fjalë gjendet në shumë gjuhë, atëhere duhet konsideruar se ajo i përket asaj gjuhe në të cilën ajo del me kuptimin e saj më të përgjithshëm, më material dhe më të nevojshëm»; «në qoftë se një fjalë paraqitet e izoluar në një gjuhë, pa lidhje të dukshme dhe pa fjalë të prejardhura ose me një numër shumë të vogël prej tyre, dhe, përkundrazi, në gjuhën tjetër ka lidhje të qarta... ose ka një varg të tërë fjalësh të prejardhura... dhe në këtë mënyrë duket se është e mpleksur në atë gjuhë, atëhere mund të përfundohet se kjo fjalë ka kaluar nga gjuha e dytë në të parën»⁴. Por Gr. Brënkushi, në kundërshtim me të gjitha këto rrethana, nuk arrin në një përfundim të tillë. Sipas mendimit të tij këto fjalë të përbashkëta mund ta kishin burimin te shqipja, sikur mënyrat e prejardhjes së tyre të mos ishin të vjetra, sikur ato të ishin formuar vetëm vonë në truallin e vetë shqipes. Megjithatë ai nuk sjell ndonjë provë që këto mënyra fjalëformimi kanë qenë aq të vjetra sa t'i njihen trakishtes, nga ana tjetër, fjalët që një gjuhë merr prej një tjetre mund të jenë të reja e të vjetra, kjo varet nga rrethanat, nga arësytet e nga shkaqet e huazimit. Fakti se shumica e fjalëve në diskutim janë të terminologjisë baritore tregon se këtu kemi të bëjmë me huazime që shpjegohen nga një zhvillim më i madh i blegtorisë te shqiptarët e lashtë në krahasim me rumunët. Për moshën jo shumë të vjetër të trajtës fonetike të disa fjalëve nga këto në vetë gjuhën shqipe flet edhe ruajtja e *s*-së si e tillë, p.sh. te prap. *-es, -ës, -esë* (*hamës, gërresë*). Po të ishin këto fjalë të kohës trake, *s*-ja do të ishte kthyer në *sh*, pasi, siç dihet, ky ndrim fonetik ka vepruar dhe pas shek. VII dhe prek edhe disa nga huazimet sllave më të vjera⁵.

Nga sa parashtroam deri këtu mund të shihet se qëndrimi i autorit për disa çështje themelore të marrëdhënjeve midis shqipes e rumanishtes nuk është bindës, nuk del nga një analizë objektive e gjithë rrethanave historike e gjuhësore. Sido që të jetë, problemi i trajtuar nga albanologu rumun në këtë artikull vazhdon të mbetet një problem i pazgjidhur në tërësinë e tij.

Duke i mbyllur këto shënime, dëshirojmë të përmëndim se, siç ka vënë në dukje me shumë të drejtë E. Çabej në artikullin e cituar, «më rëndësi se një shpjegim aprioristik i lidhjeve rumuno-shqiptare ka konstatimi dhe vlerësimi i drejtë i tyre. Gjykimi përfundimtar për llojin e për gradën e kësaj afërie gjuhësore, si në përgjithësi, si në pikat e veçanta ka për të dalë vetëvetiu, kur materiali të dihet mirë dhe të jetë sqaruar më mirë». Shpjegimi i lidhjeve shqiptaro-rumune është një problem i tillë kompleks, që kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis gjuhëtarëve nga njëra anë dhe etnografëve, historianëve e arkeologëve nga ana tjetër.

EMIL LAFE

3) Shih për këtë më gjerë E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, (dispensë) Tiranë, 1960 f. 77.

4) Shih O.S. Shirokov, «*Ekrem Çabej, Etjudy po etimologjiu allbanskogo jazyka*», I-III në «*Etimologija*» Izdatelstvo Akademii Nauk SSSR, Moskë 1963, f. 305, shën. 14; Rasmus Rask, *Gjurmime në fushën e gjuhës së vjetër të Veriut ose burimi i islandishtes*, në librin e V.A. Zvegincevit, *Istoriya jazykoznanija XIX-XX vekov v oçerkah i izvleçenijah*, çast I, Moskë 1964, f. 45.

5) Shih E. Çabej, *vep. cit.* f. 121.

